



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor, 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.05.2022, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR SUBVENCIONIMIN E KLUBEVE TË BASKETBOLLIT, HENDBOLLIT DHE**  
**VOLEJBOLLIT**

**I.**

**MIRATOHET** Vendimi për subvencionimin e klubeve të basketbollit, hendbollit dhe volejbollit në Prishtinë.

**II.**

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 127,000.00 €, për klubin e basketbollit KB "Sigal Prishtina", meshkujt, 53,000.00 €, për klubin e basketbollit KBF "Prishtina, femrat, 20,000.00 €, për klubin e hendbollit KH "Prishtina", meshkujt, 32,000.00 €, për klubin e volejbollit KV "Prishtina", meshkujt, 11,000.00 €, dhe për klubin e volejbollit KV "Prishtina", femrat, 11,000.00 €, shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve.

**III.**

Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve për përkrahjen e këtyre klubeve të qytetit për mbarëvajtjen e aktiviteteve, performancën më të mirë dhe përfaqesim sa më të denjë të qytetit tonë, si në garat vendore ashtu edhe në ato ndërkombëtare.

**IV.**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria e Sportit dhe Drejtoria e Financave.

**V.**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-451/01-103581/22, 12.05.2022

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Fehmi Kupina

